

VENDIM
Nr. 44, datë 13.5.2014

**MBI ANKIMIN E CEZ SHPËRNDARJE SHA NË
ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM MBI
VENDIMIN NR. 27, DATË 31.3.2014 "PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MBI
VERIFIKIMIN E MATËSVE KUR FUTEN PËR
HERË TË PARË NË TREG DHE/OSE KUR
VENDOSEN PËR HERË TË PARË NË
PËRDORIM; INSPEKTIMIN PERIODIK PËR
VERIFIKIMIN E SAKTËSISË SË MATËSVE DHE
TË SISTEMIT TË MATJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, KOLAUDIMIN DHE VULOSJEN, SI
DHE TË MIRËMBAJTJES SË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, mbasi shqyrtoi ankimimin e shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. në lidhje me vendimin nr. 27, datë 31.3.2014 "Për miratimin e kontratës tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre",

konstatoi se:

"CEZ Shpërndarje" është njoftuar për vendimin nr. 27, datë 31.3.2014, me anë të shkresës nr. 288/1 Prot., datë 1.4.2014.

Ankimi siç citohet edhe me sipër është dërguar në ERE me shkresën nr. 3727/1 Prot., datë 28.4.2014.

Baza ligjore për paraqitjen e këtij ankimi i është referuar nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, në të cilin përcaktohet se:

"Për aktet me karakter normativ, çdo palë e përfshirë në proces mund të paraqesë në ERE një kërkesë për rishikim vendimi të Bordit të Komisionerëve brenda 5 ditë pune nga data e marrjes së njoftimit të vendimi të Bordit. Kërkesa për rishikim vendimi do të shoqërohet detyrimisht me provat e reja që mendohet se mund të çojnë Bordin në një vendimmarrje të re. ERE do të trajtojë kërkesën për rishikim vendimi brenda 30 ditëve kalendarike duke ndjekur të njëjtin proces që shërbeu për miratimin e vendimit. Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit, me përjashtim kur Bordi i Komisionerëve vendos ndryshe."

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankimit të "CEZ Shpërndarje" sh.a. për vendimin nr. 27, datë 31.3.2014 "Për miratimin

e kontratës tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë ankimuese "CEZ Shpërndarje" sh.a., dhe DPM për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

